



**FEMART FESTIVAL
8TH EDITION**

SOLIDARITY AND RESILIENCE

15-20 OCT 2020, PRISHTINA



© Qendra për Art dhe Komunitet - Artpolis - 2020 / © Art and Community Center - Artpolis - 2020

Autore / Author: Artpolis

Dizajn / Design: KomitetiStudio

Ky botim është bountuar në kuadër të Festivalit Femart. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Qendrës për Art dhe Komunitet - Artpolis dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret për të pasqyruar pikëpamjet e donatorëve tanë.

This publication was published as part of the Femart Festival. The contents of this publication are the sole responsibility of the Center for Art and Community - Artpolis and can in no way be taken to reflect the views of our donors.



**FEMART FESTIVAL
8TH EDITION**

**SOLIDARITY AND RESILIENCE
15-20 OCT 2020, PRISHTINA**

PËRMBAJTJA

EKSPOZITË “AKTI I MBRËMJES”	10
KONCERT – ANSAMBLI “ZANAT”	15
PUBLIKIMI I RAPORTIT & KONFERENCË - “Drejt Solidaritetit dhe Bashkëpunimit” - analizë mbi përfaqësimin e grave në shoqëri civile, media dhe institucione të kulturës në Kosovë.	16
PODCAST & DISKUTIM “FEMINIZËM, MENINIZËM A HUMANIZËM?”	18
PERFORMANCË “ A JE ÇIKË, A JE DJALË!?... Premierë – Produksioni Artpolis	19
PUNËTORI “MËSIMET NGA ZED”	21
PODCAST “E ÇKA KE TI, ASI A KSI? HOMO, HETERO DHE GJITHÇKA NË MES E JASHTË TYRE”	22
PODCAST “PENISI, VAGINA EDHE KREJT TJERAT: MËSIMET E BIOLOGJISË QË S’U DHANË KURRË;”	22
EKSPOZITË “NË PËRQAFIM ME ZZ”	23
SHFAQJE TEATRALE “TRI MOTRAT & NATASHA”	25
PODCAST “A BON ME T’PREK?”	27
PERFORMANCË & DISKUTIM “SILVER BOOM” (Festivali HAPU në FEMART)	28
SHFAQJE TEATRALE “TI, JAM UNË”- Premierë – produksioni Artpolis	31
FORUM DANCE TEATËR “ÇFARË DUAN BURRAT!?” - Premierë / Produksioni Artpolis	32
PUNËTORI “COVIDIA DELL” ARTE”	33
PODCAST “MËSIMI 1: OYSH ME E DASHTË VETEN OE ME E DASHTË EDHE TJETRIN”	33
FILMAT E REGJISOREVE KOSOVARE & PANEL DISKUTIMI	34
PERFORMANCË BALETI “LIDHMË MUA”	39
PODCAST “ME NJI LULE S’QEL PRANVERA; ME KEMBE E DURE, BASHKE E PERPARA”	40
PUBLIKIM BROSHURE & PANEL DISKUTIMI “ARTIVIZMI - ARTI DHE SOLIDARITETI NË KOHË PANDEMIE”	41
PERFORMANCË “T’U E MARRË “FUQINË” N’PYTJE” - Premierë - Produksioni Artpolis	43
SHFAQJE MUZIKORE “ZGJIMI I PRANVERËS”	44

CONTENT

EXHIBITION "EVENING NUDE"	10
CONCERT - ENSEMBLE "ZANAT"	15
REPORT PUBLISHING & CONFERENCE "Towards Solidarity and Cooperatio"- an analysis women's representation in civil society, media and cultural institutions in Kosovo.	16
PODCAST & DISCUSSION "FEMINISM, MENINISM, OR HUMANISM?"	18
DRAG PERFORMANCE "ARE YOU A BOY OR ARE YOU A GIRL!?... Artpolis premiere production	19
WORKSHOP "TEACHINGS OF ZED"	21
PODCAST "ARE YOU THIS OR THAT? HOMO, HETERO AND EVERYTHING ELSE INSIDE AND OUT"	22
PODCAST "THE PENIS, THE VAGINA, AND EVERYTHING ELSE: BIOLOGY LESSONS WE WERE NEVER TAUGHT"	22
EXHIBITION "IN HUG WITH ZZ"	23
THEATER PERFORMANCE "THREE SISTER & NATASHA P."	25
PODCAST "CAN I TOUCH YOU?"	27
PERFORMANCE "SILVER BOOM" & DISCUSSION (HAPU Festival in FEMART)	28
THEATER PERFORMANCE "YOU, IT'S ME" Artpolis Premiere Production	31
FORUM DANCE THEATRE "WHAT DO MEN WANT!?" - Artpolis Premiere Production	32
WORKSHOP "COVIDIA DELL" ARTE"	33
PODCAST "LESSON NO.1: HOW TO LOVE YOURSELF SO YOU CAN LOVE SOMEBODY ELSE"	33
KOSOVO WOMEN DIRECTORS MOVIE NIGHT & PANEL DISCUSSION	34
DANCE PERFORMANCE "TIE ME UP"	39
PODCAST "SPRING DOESN'T BLOOM WITH ONE FLOWER; CRAWLING FORWARD AND UNITED"	40
PUBLICATION OF BROCHURE & PANEL DISCUSSION "ARTIVISM - ART AND SOLI- DARITY IN TIMES OF A PANDEMIC"	41
PERFORMANCE "INTERROGATING "POWER" - Artpolis Premiere Production	43
MUSICAL THEATER "SPRING AWAKENING"	44



Përshëndetje nga drejtoresha e festivalit Femart, Zana Hoxha.

“Kohërave të jashtëzakonshme u duhen artistë që rezistojnë”

Të dashur artiste/ë, aktiviste/ë, shoqe e shokë e mbështetës të festivalit FemArt - 2020-ta është vit i vështirë por arti lulëzon edhe në vendet më të izoluar dhe do të vazhdojë të ketë jetë në planetin Tokë.

Ky edicion i jashtëzakonshëm i FemArt-it do të jetë festivali i parë i organizuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në vitin 2020 në Kosovë për shkak të pandemisë me COVID-19 dhe më duhet ta pranoj që ky edicion do të përfshijë më së shumti artiste/ë vendor sesa ndonjë edicion tjetër i FemArt-it deri tani.

Gjatë 7 viteve të kaluara, FemArt u bë festival feminist i njohur ndërkombëtarisht, duke iu mundësuar mijëra grave dhe vajzave të njohin dhe pranojnë të drejtat e tyre të plota përmes artit të mirë dhe cilësor të krijuar nga artiste dhe aktiviste në mënyrë që të arrihet barazia në nivel politik, ekonomik, kulturor, personal dhe shoqëror.

Ne kemi vendosur që festivalin FemArt 2020 ta emërojmë nën moton “Solidaritet dhe Qëndrueshmëri”. Solidariteti si parim i mbështetjes së ndërsjellë në mes grave dhe vajzave, artisteve dhe aktivisteve që punojnë për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave dhe qëndrueshmëri si aftësi për t’i bërë ballë fatkeqësive, traumave dhe sfidave duke u ngritë në këmbë sa herë rrëzohemi e duke e ngritë zërin sa herë që mundohen të na heshtin.

Duke e pasur parasysh ndikimin e krizës financiare të shkaktuar nga pandemia, ishte shumë e rëndësishme që ne të krijojmë hapësirë, mbështetje financiare dhe mjedis të sigurt për 160 artistet/artistët, aktivistet/aktivistët dhe të rinjtë që do të marrin pjesë në edicionin e 8të të Festivalit FemArt 2020.

Ju urojmë mirëseardhje me nga një përqaftim virtual dhe iu ftojmë që të ndiqni programin tonë të mrekullueshëm me shpresën që do ta rrisim solidaritetin dhe qëndrueshmërinë e të gjithë njerëzve të Kosovës.

REZISTO! INSPIRO! KRIJO!

Zana Hoxha
Themeluese dhe Drejtoreshë e Festivalit Femart.

Greetings by Zana Hoxha Femart Festival Director

“Extraordinary times call for resilient artists”

dear artists, activists, friends and supporters of FemArt Festival - 2020 is a rough year but Art thrives even in the most remote places and will continue to be created as long as we are all here in our Mother Earth.

This incredible edition will be the first live festival taking place during 2020 in Kosovo considering COVID-19 situation and I must admit, it's going to be the most locally sourced edition of FemArt ever.

For the past 7 years, FemArt became an internationally recognized feminist festival, which has managed to empower thousands of women and girls in the recognition of their full rights through good and quality art created by artists and activists in order to achieve equality in political, economic, cultural, personal, and social level.

We have decided to name FemArt Festival 2020 under the motto “Solidarity and Resilience”. Solidarity as a principle of mutual support between women and girls, artists and activists working for gender equality and women’s rights and Resilience as the ability to face adversity, trauma and challenge by standing up whenever we fall and raising our voice whenever they try to silence us.

Considering the impact of the financial crisis created due to the pandemic, it was important that we create space, financial support and a safe environment for 160 artists, activists and youth who will participate in the 8th Edition of FemArt Festival, 2020.

We welcome you with a virtual hug and invite you to follow our amazing program that will hopefully strengthen the solidarity and resilience amongst all people of Kosovo.

RESIST! INSPIRE! CREATE!

Zana Hoxha
Founder and Director of FemArt Festival



FEMART FESTIVAL
SOLIDARITETI DHE QËNDRUESHMËRIA
EDICIONI 8
15-20 TETOR 2020, PRISHTINË

FemArti është festival feminist i njohur ndërkombëtarisht, i cili ka arritur që përmes artit të mirë dhe kualitativ të krijuar nga artistet dhe aktivistet të fuqizojë gratë dhe vajzat në njohjen e të drejtave të tyre të plota me qëllim të arritjes së barazisë politike, ekonomike, kulturore, personale, dhe shoqërore.

Moto e festivalit FemArt 2020 është “Solidariteti dhe Qëndrueshmëria”.

Solidariteti si parim i mbështetjes së ndërsjellë në mes grave dhe vajzave, artisteve dhe aktivisteve që punojnë për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave. Qëndrueshmëria si aftësi për t'i bërë ballë fatkeqësive, traumave dhe sfidave duke u ngritë në këmbë sa herë rrëzohemi e duke e ngritë zërin sa herë që mundohen të na heshtin.

Koncepti dhe formati i festivalit FemArt këtë edicion ka ndryshuar si rezultat i përballjes me COVID-19. Në solidaritet dhe përkrahje FemArt do të sjellë krijime artistike origjinale nga artistet dhe aktivistet e vendit.

Përgjatë shtatë edicioneve të kaluara FemArt Festival ka sjellur më shumë se 240 aktivitete artistike dhe kulturore si dhe ka mbledhur rreth 25,000 persona në audiencë.

FemArt is an internationally recognized feminist festival, which has managed to empower women and girls in the recognition of their full rights through good and quality art created by women artists and activists to achieve political, economic, cultural, personal, and social equality.

The motto of the FemArt Festival 2020 is “Solidarity and Resilience”.

Solidarity as a principle of mutual support between women and girls, women artists and activists working together for gender equality and women’s rights. Resilience as the ability to face adversity, trauma, and challenge by getting back on our feet whenever we fall and raising our voice whenever they try to silence us.

The concept and format of FemArt festival this edition has changed as a result of facing COVID-19. In solidarity and support, FemArt will bring original artistic creations by local women artists and activists.

Over the past seven editions, FemArt Festival has brought more than 240 artistic and cultural activities as well as gathered around 25,000 people in the audience.

FemArt në Etno Fest – Solidariteti dhe Qëndrueshmëria

FemArt u prezantua me shfaqjen skenike “Gjuetaret e Artemidës nga Zana Hoxha dhe ekspozitën e pikturave “Holocaust” nga Mirjeta Qehaja me datë 25.09.2020 në festivalin Etno Fest – edicioni i 10-të.

Emocionet e bukura dhe ngazëllimi ynë u kurorëzua me mirënjohje nga publiku por edhe nga festivali Etno Fest 10, me çmime nga juria profesionale:

1. Shfaqja më e mirë: Gjuetaret e Artemidës
2. Performanca më e mirë: Gjuetaret e Artemidës

FemArt in Etno Fest - Solidarity and Resilience

FemArt was presented with the performance “Artemis’s Huntresses” by Zana Hoxha and the exhibition of paintings “Holocaust” by Mirjeta Qehaja. Femart in Etno fest was realized on 25.09.2020 in the Etno Fest festival – 10th edition.

Our beautiful emotions and excitement were rewarded with gratitude from the public but also from the Etno Fest 10 festival, with awards from the professional jury:

1. The best play of the festival: Artemis’s Huntresses
2. The best performance of the festival: Artemis’s Huntresses



Gjuetarët e Artemidës

Inspiruar nga natyra dhe bukuritë e saja të fshatit Kukaj, aty ku hapësira dhe çdo gjë që e rrethon këtë ambient është në harmoni me tokën dhe qiellin, nisi një tregim i jashtëzakonshëm i performancës “Gjuetaret e Artemidës”. Ky proces krijues filloi nga një vizitë në natyrën e qetë, që ishte shërim për trupin dhe shpirtin, e që e frymëzoi regjisoren Zana Hoxha, të krijojë një vepër që është në përputhje me natyrën si perëndeshë shëruese, burim i jetës dhe energji e pashtershme. “Gjuetaret e Artemidës” dalëngadalë u formësuan duke personifikuar shpirtin e një gruaje të pavarur duke bërë rrituale pagane dhe duke dhënë dashuri e solidaritet në harmoni me natyrën. Koreografia, muzika, kostumet dhe performanca e aktoreve, ishin rezultat i emocioneve dhe ndjenjave që zgjoi kjo simbiozë e natyrës me gruan, dhe artin, e cila u përshat plotësisht me vendin, atmosferën dhe ngjarjen e Etno Fest-it.

Performancë skenike “Gjuetaret e Artemidës”

Nga: Zana Hoxha

Muzika: Arbër Salihu

Koreografia: Robert Nuha

Aktoret: Aurita Agushi, Semira Latifi, Donikë Ahmeti, Daniela Mar-

kaj, Qëndresa Kajtazi, Hajat Toçilla, Fitore Jashari.

Kostumograf: Arbnor Brahimi

Asistente teknike: Elira Lluka

Video: Event Recording Agency: Fitmi Hajdari, Gëzim Rexhepi, Veton Berisha

Editimi i Videos/ Video editing: Bujar Ahmeti

Artemis’s Huntresses

Inspired by the nature and its beauties of the village of Kukaj, where space and everything that surrounds this environment is in harmony with the earth and the sky, began an extraordinary story of the performance “Artemis’s Huntresses”. This creative process started from a visit to the peaceful nature, a healer for body and soul, and inspired the theatre director Zana Hoxha, to create a work that is in accordance with nature as a healing goddess, source of life and inexhaustible energy.

The “Artemis’s Huntresses” were slowly shaped by personifying the soul of an independent woman by doing pagan rituals and giving love and solidarity in harmony with nature. The choreography, music, costumes and performances of the actresses are the result of the emotions and feelings that this symbiosis of nature with woman and art evoked, and was fully in accordance to the place, atmosphere and the Ethno Fest event.

The performance “Artemis’s Huntresses”.

From: Zana Hoxha

Music: Arbër Salihu

Choreography: Robert Nuha

Actresses: Aurita Agushi, Semira Latifi, Donikë Ahmeti, Daniela Markaj, Qëndresa Kajtazi, Hajat Toçilla, Fitore Jashari.

Costumes: Arbnor Brahimi

Technical assistant: Elira Lluka

Ekspozita e Pikturave “Holocaust”

Kjo ekspozitë nga Mirjeta Qehaja paraqet problemet me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, personat me aftësi të kufizuara e grupe të tjera shoqërore, që për Mirjetën paraqesin një holokaust modern, të cilëve nuk iu rrezikohet jeta drejtpërdrejtë por në mënyrë latente.

Exhibition “Holocaust”

This exhibition by Mirjeta Qehaja presents the problems faced by members of non-majority communities, people with disabilities and other social groups, which for Mirjeta represent a modern holocaust, whose lives are not endangered directly but latently.



EKSPOZITË "AKTI I MBRËMJES"

EXHIBITION "EVENING NUDE"

📅 15.10.2020 – DITA E PARË/DAY ONE (E ENJTE/THURSDAY)

🕒 19:00 – 20:00

📍 GALLERY AT FACULTY OF ARTS

Kuruar nga/Curator: ARTA AGANI

Artistët pjesëmarrës në ekspozitë/Artists participating in the exhibition: Adea Pula, Ardiana Sedaj, Ardita Rafuna, Artan Hajrullahu, Besfort Sylja, Fjolla Ferati, Jakup Ferri, Lumjete Havolli, Vlora Hajrullahu dhe Zake Prevukaj.

Jetomjë në një kohë kur pamja e jashtme është gjithçka, mediat sociale janë njësi matëse e suksesit, vlerat janë të kthyer mbrapsht ndërsa standardet e imponuara të bukurisë janë praktikisht të paarrtshme. Si rezultat, njerëzit i kushtojnë kohën e vlefshme vlerave sipërfaqësore ndërsa efekti që arrihet është negativ dhe dëmton marrëdhëniet ndërnjerëzore, e në disa raste çon edhe te gjendja e rëndë psikologjike. Ekspozita Akti i Mbrëmjes hulumton paraqitjen, keqpërdorimin dhe keqinterpretimin e trupit në mediat sociale dhe në art, e sidomos artin në internet, derisa ky interpretim nuk është gjithmonë i drejtpërdrejtë. Këtu vihet në pyetje relacioni mes artistit si individ dhe censurave të shoqërisë patriarkale, ndërsa diskutohet fenomeni i standardeve të reja të bukurisë, simboleve seksuale të statusit si dhe pasojat e vetë-objektifikimit në mediat e shekullit tonë.

We live in a time where how you look is everything; social media have become the measuring unit of success; values have been turned upside down, while imposed standards of beauty are practically unachievable. As a result, people spend their valuable time on superficial values while the effect achieved is negative and harms interpersonal relations, and in some cases it even leads to severe psychological condition. The exhibition The Evening Act researches appearance, misuse and misinterpretation of the body in social media and arts, especially online art, while this interpretation is not always direct. This brings into question the relation between the artist as an individual and the censorship of the patriarchal society, while discussing the phenomenon of the standards of the new beauty, sex status symbols and consequences of self-objectification in the media of our century.



Arta Agani (1973) jeton dhe punon në Prishtinë.

Nga gushti i vitit 2016 deri në gusht të vitit 2020, ajo ishte drejtoreshë e Galerisë Kombëtare të Kosovës. Ajo është gjithashtu profesore dhe Tipografisë në 'Akademia Evolucion' për Dizajn të Komunikimit që nga viti 2007.

Karriera e saj profesionale përfshin dizajnin, si profesionin e saj kryesor, projektet artistike dhe ekspozitat, përqendrimin në menaxhimin e projekteve artistike dhe kurimin e disa ekspozitave. Angazhimet e saj më të fundit ishin në vitin 2017 si kurator i Pavijonit të Kosovës në Bienalen e 57-të të Venecias me artistin Sislej Xhafa dhe në vitin 2019 si komisioner i Pavijonit të Kosovës në Bienalen e 58-të të Venecias me kuratorin Vincent Honore dhe artistin Alban Muja. Më 2019 ishte pjesë e ekipit kuratorial në ekspozitën kolektive SELFIE (sh) ME në Piran, Sloveni.

Ajo gjithashtu kuror ekspozitën Perception: Burnneshat në Galerinë Kombëtare në 2018, me koleksionin e Këshillit Britanik me fokus në gratë artiste si Sarah Lucas, Tracey Emin, Rachel Whiteread, Claire Strand, etj.

Arta Agani (1973) lives and works in Prishtina.

From August 2016 to August 2020, she was the director of The National Gallery of Kosovo. She is also a professor of Typography at 'Akademia Evolucion' for Communication Design since 2007.

Her professional career encompasses design, as her primary profession, artistic projects and exhibitions, concentrating in managing artistic projects, and curating several exhibitions. Her most recent engagements were in 2017 as curator of Kosovo Pavilion at the 57th Venice Biennale with artist Sislej Xhafa, and in 2019 as commissioner of Kosovo Pavilion at the 58th Venice Biennale with curator Vincent Honore and artist Alban Muja. In 2019 she was part of the curatorial team at a larger group exhibition in Piran, Slovenia, SELFIE (sh) ME.

She also curated the exhibition Perceptions: Burnneshat at the National Gallery in 2018, with British Council collection with focus on women artists like Sarah Lucas, Tracey Emin, Rachel Whiteread, Claire Strand, etc.




Adea Pula (1993) jeton dhe punon në Prishtinë.

Karriera e saj profesionale përfshin dizajnin e komunikimit vizual, si profesionin e saj kryesor, dhe poashtu projektet artistike dhe ekspozitat. Angazhimet e saj të fundit përfshijnë ekspozitën grupore në Beograd / Novi Sad dhe Artistët e Rinj '19 në Galerinë Kombëtare të Kosovës.

Puna e saj në komunikim vizual dhe multimedia ndërthuret me projektet e artit konceptual, ku shumica e projekteve përfshijnë teknologji bashkëkohore dhe media sociale. Gjithmonë duke u munduar që temat sociale të jenë pika kyçe e krijimeve të saj.

Adea Pula (1993) lives and works in Prishtina.

Her professional career includes visual communication design as her main profession as well as art projects and exhibitions. Her recent engagements include the group exhibition in Belgrade/Novi Sad and the Youth Artists '19 at the National Gallery of Kosovo. Her work in visual and multimedia communication intertwines with conceptual art projects, where most of the projects include contemporary technology and social media. Always trying to make social topics the main point of her creations.




Ardita Rafuna (12 korrik 1999) u lind në Unna-Gjermani kurse jeton në Prishtinë.

Vijon studimet për pikturë në vitin e tretë, në Fakultetin e Arteve, në Universitetin e Prishtinës. Përveq pikturës ka pasion edhe fotografimin, leximin, filmin, shkrimet, performimin dhe dizajnin e modës.

Gjatë studimeve të deritanishme ishte pjesëmarrëse në ekspozitat kolektive studentore në Fakultetin e Arteve. Në verën e vitit 2019 mori pjesë në shkollën verore të organizuar nga Stacion - Qendra për Art Bashkëkohor si dhe në festivalin e muraleve "MOS". Në fund të 2019 mori pjesë në masterklasën për dramaturgj të dramaturgut gjerman Roland Schimmelpfennig të organizuar në zryet e Qendrës Multimedia.

Në një të ardhme jo të largët synon të depërtojë në botën e filmit, qoftë si aktore apo edhe prapa kamerave dhe realizimit të filmit.



Ardita Rafuna - I bloomed for myself, I bloomed for you

Ardita Rafuna (July 12, 1999) was born in Unna-Germany and lives in Prishtina.

She continues her studies for painting in the third year, at the Faculty of Arts, at the University of Prishtina. In addition to painting, she has a passion for photography, reading, films, writing, performing and fashion design.

During her studies so far she has participated in collective student exhibitions at the Faculty of Arts. In the summer of 2019 she participated in the summer school organized by Stacion - Center for Contemporary Art also in the mural festival «MOS» 2019. At the end of 2019 she participated in the playwriting masterclass of the German playwright Roland Schimmelpfennig, organized in the offices of the Multimedia Center.

In the not too distant future she aims to debut into the world of film, either as an actress or even behind the cameras and filmmaking.



Artan Hajrullahu (lindur në 1979 në Gjilan -Kosove), studioi Pikturën në Akademinë e Arteve, Universiteti i Prishtinës. Hajrullahu ligjëron linden e Pikturës në Shkollën e Mesme të Arteve Pamore në Gjilan.

Ai ka ekspozuar në: Bienalen Ndërkombëtare të Vizatimit në Prishtinë, 2010; Artistet e se Nesermes në Prishtinë, 2013; Galeria Kombëtare e Maqedonisë «Mala Stanica», 2014; Collectif Denface «Rouen-France, 2015, Galeria e Arteve G12HUB nëBeograd, 2015;»This Is Not a Palm Tree» Neurotitan Gallery (Berlin), 2015; Qendra Sodobnih Umetnosti, Celje, Sloveni, 2016, «; Autostrada Bienale, Prizren, 2017; Cmimi i Ekspozitës Ndërkombëtare Muslim Mulliqi, 2018; Selfi / sh / ME, Obalne Galeria Piran, Siloveni, 2019;

Ekspozitat e tij individuale janë mbajtur në: Muzeun Kombëtar të Historisë në Tiranë, 2006; Galeria Kombëtare e Kosovës «Prishtinë», 2010; Ekspozita «Bajraktari» në Tetris, 2011; International Studio & Curatorial Program ISCP «New York», 2014, Qendra e Kulturës Tulla në Tiranë, 2015.

Çmimet:

- "Flaka e Janarit, 2006.
- "Artistët e së nesërmes» dhe Artisti Vitit, Gjilan,2013.
- "Bianaja Muslim Mulliqi", 2018.


Artan Hajrullahu (born in 1979 in Gjilan, Kosovo) studied Painting at the Academy of Arts, University of Prishtina. Hajrullahu teaches Painting at the High School of Visual Arts in Gjilan.

He has had exhibitions at the International Biennale of Drawing, Prishtina, 2010; Artists of the Future, Prishtina, 2013; Mala Stanica, National Gallery of Macedonia, 2014; Collectif Denface Rouen, France, 2015; G12HUB Gallery of Arts, Belgrade, 2015; This is Not a Palm Tree, Neurotitan Gallery, Berlin, 2015; Art Gallery, Celje, Slovenia, 2016; Autostrada Biennale, Prizren, 2017; Won the Award of Muslim Mulliqi International Exhibition, 2018; Selfie/sh/ME, Obalne Galerije, Piran, Slovenia, 2019.

His individual exhibitions include those at the National Museum of History, Tirana, 2016; National Gallery of Kosovo, Prishtina, 2010; Bajraktari Exhibition at Tetris, 2011; International Studio & Curatorial Program ISCP, New York, 2014, Tulla Cultural Centre, Tirana, 2015.

Awards:

- Flaka e Janarit (January's Torch), 2006;
- Artists of the Future, and Artist of the Year, Gjilan, 2013;
- Muslim Mulliqi Biennale, 2018.





Besfort Sylja, 21 vjeç, jeton dhe punon në Prishtinë.

Ai është student i dizajnit të komunikimit në "Akademia Evolucion" dhe aktualisht punon si dizajner dhe fotograf në Kosovë dhe jashtë saj, duke e parë si shumë të rëndësishme që të përdorë platformën dhe punën e tij për të nxjerrë në pah dhe trajtuar çështjet sociale siç janë dhuna në familje, identiteti gjinor, diskriminimi e shume tema tjera. Me bashkëpunim me artista tjerë shqiptarë , ai poashtu ka për qëllim që të tregojë punën e pandalshme që artistët nga Kosova e bëjnë pa marr parasysh sfidave në të cilat hasim. Përveç artit, që nga viti 2018 ai poashtu është pjesë e Initiatives of Change, Switzerland (iofC) duke marrur pjesë në ngjarje, trajnime, konferenca të temave si: Creative Leadership, Children as Actors and Transforming Society, Europe's Unfinished Business etj.

Besfort Sylja, 21 years old, lives and works in Prishtina.

He is a Communication Design student in "Evolution Academy" and currently works as a designer and photographer in Kosovo and abroad where he finds it as very important to use his platform and work to highlight and tackle social issues such as domestic violence, gender identity, discrimination and many more.

In collaboration with other Albanian artists, he also aims to show the unstoppable work that artists from Kosovo do regardless of the challenges we face.

Additionally, since 2018 he has been alumni of Initiatives of Change, Switzerland (iofC) participating in events, trainings, conferences on topics such as: Creative Leadership, Children as Actors and Transforming Society, Europe's Unfinished Businesses etc.

In the same year she was part of a collective exhibition in Switzerland with Infinity art in Basel.

She still creates and works on representing her work in many events and exhibitions now on



Jakup Ferri 1981 Prishtinë, Kosovë Arsimitimi: 2007/2008 Rijksakademie Van Beeldende Kunsten, Amsterdam | 2001/2004 Akademia e Arteve të Bukura , Prishtinë Çmimet: Bienalja Ndërkombëtare e Vizatimit 2020, Prishtinë | 2008 Buning Brongers Prijzen, Amsterdam | 2006 Kunstpreis Europas Zukunft (E Ardhmja e Evropës), Muzeu i Artit

Bashkëkohor (GfZK) Leipzig | 2003 Çmimi Muslim Mulliqi, Prishtinë | 2003 Artistët e së nesërme, Prishtinë

Ekspozitat e zgjedhura solo:

Galeria Kombëtare e Kosovës. Spitali i Kalit, Londër. Projektet Bradwolfof, | Amsterdam. Hula Hoop transparente, Galeria Andriess-Eyck, | Amsterdam. Hapësira e Artistëve, New York | Ekspozitat e zgjedhura në grup: Triena e Hannah Ryggen. Balena që ishte një nëndetëse, Muzeu Ludwig, Budapest. | Tembe fu Libi, Suriname. Zëri i zotit të tij, HMKV, | Dortmund & Montpellier. Gjeniu pa talent, de Appel, Amsterdam | Niet Normaal, Beurs van Berlage, Amsterdam | Quadrennial U-TURN për Art Bashkëkohor, Kopenhagë | Stamboll, Biennale Ndërkombëtare e Stambollit, Stamboll

Jakup Ferri, 1981 Prishtina, Kosovo

Education: 2007/2008 Rijksakademie Van Beeldende Kunsten, Amsterdam | 2001/2004 Academy of Fine Arts, Pristina

Prizes: 2020 International Drawing Biennale, Prishtina | 2008 Buning Brongers Prijzen, Amsterdam | 2006 Kunstpreis Europas Zukunft (The Future of Europe), Museum of Contemporary Art (GfZK) Leipzig | 2003 Muslim Mulliqi prize, Pristina | 2003 Artists of tomorrow, Pristina

Selected Solo Exhibitions: The National Gallery of Kosovo. The Horse Hospital, London. Bradwolfof | Projects, Amsterdam. Transparent Hula Hoop, Andriess-Eyck Gallery, | Amsterdam. Artists Space, New York

Selected Group Exhibitions: Hannah Ryggen Triennial. The Whale That Was a Submarine, Ludwig | Museum, Budapest. Tembe fu Libi, Suriname. His master's voice, HMKV, | Dortmund & Montpellier. Genius without Talent, de Appel, Amsterdam | Niet Normaal, Beurs van Berlage, Amsterdam | U-TURN Quadrennial for Contemporary Art, Copenhagen | Istanbul, International Istanbul Biennale, Istanbul



Fjolla Ferati ka lindur me 09.11.1997 ne Qytetin e Vushtrrisë. Jeton, vepron dhe studion ne Prishtine. Qysh ne vitet e hershme ka filluar qe arti te jete pjese e saj, kështu edhe filloi edhe studimet e larta ne Akademinë e Arteve ne Prishtine në Degën Grafike, këtë vit në vitin përfundimtar të studimeve. Qysh në fillim,

pjesëmarrja në ekspozita te ndryshme ishte e madhe, ekspozita kolektive ku çdo herë ka paraqitur diçka të re për publikun. Për shkak të moshës dhe studimeve në akademi, nuk ka mbajtur ende ekspozitë personale por që shumë shpejtë do të vijë me një koncept të ri për të .

Në vitin 2017 dhe 2018 ka qenë pjesë e një numri të madh të ekspozitave kolektive brenda dhe jashtë Kosovës, kurse ne vitin 2019 në kuadër të ideve kreative, në mesin e 3 ideatoreve në kuadër te Forumit për Iniciativa Qytetare FIC ka fitur qe ideja e saj për Gleri Online në Kosovë të prezantohet në Itali- Romë.


Po në të njëjtin vit ka marrë pjesë në një ekspozite Kolektive në Zvicer në kuadër te grupit Infinity Art . Edhe sot ajo vazhdon të jetë pjesëmarrëse në shumë evente dhe ekspozita duke prezantuar punën e saj.

Fjolla Ferati was born in 09.11.1997 in the city of Vushtrri . Now she lives , creates and studies in Prishtina . In her early years , art was always part of her life , that she started studying at the Academy of Arts in Prishtine , at Printmaking Lessons , now she is at her last year of studing .

Since in the start she was part of a lot of different exhibitions , where everytime she used to show something new for the public .

Because of her age and being still a student she never opened her own personal exhibition , but she soon will come with a new concept for making one , especially she will work to open it out of Kosovo .

At 2017 and 2018 she was part of a lot of collective exhibitions in Kosovo and other states in Europe , and at 2019 because of a creative idea she came with , in collaboration with FIC her idea was presented in the School of art in Italy Rome .




Lumjete Havolli Blakçori përfundoi studimet baçelor dhe master në Skenografi-Dizajn Skene në Fakultetin e Arteve të Bukura në Universitetin e Prishtinës. Që nga viti 2004, ajo ka qenë e angazhuar në aktivitetet të ndryshme të artit dhe ka organizuar projekte arti, siç janë për mbrojtjen e mjedisit, koloninë e artistëve, ekspozita, dizajn skene dhe ka

punuar kukulla për teatrin e fëmijëve. Ajo ka punuar në MAK (Ndihma e Mançesterit për Kosovën/Manchester Aid for Kosovo) prej vitit 2006 gjatë shkollës verore dhe me projekte të tjera. Prej vitit 2010 deri më 2014, ajo ka mbajtur kurse personale të artit për fëmijët e Podujevës. Prej vitit 2017, ajo është e certifikuar në Dizajnin Grafik nga WOW (Women in Online Working) nga Universiteti Amerikan në Kosovë, EYE dhe RIT Kosova. Prej vitit 2018, Lumjeta punon si mësuese e artit në Shkollën Ndërkombëtare të Cilësisë në Kosovë.

Frymëzimi i saj për artin vjen nga natyra, sjelljet njerëzore, bota magjike e fëmijëve, intuita dhe instikti i gjallesave. Ajo krijon art në medime të ndryshme dhe përdor teknika dhe materiale të ndryshme.

Lumjeta Havolli Blakcori finished her BA and MA studies on Set Design in Faculty of Fine Arts at Pristina University. Since 2004 she has been involved in various art activities and has organized artistic projects such as protect the environment, artists' colony, exhibitions, set design and has created puppets for childrens theatre. She worked at MAK (Manchester aid to Kosovo) since 2006 in summer school and other projects. She held personal art classes to Podujeva children since 2010 to 2014. She is certificated as Graphic Designer in WOW (Woman in Online Working) from A.U.K, EYE and R.I.T Kosova since 2017. Lumjeta works at Quality School International Kosovo as an art teacher since 2018.

Her art inspiration comes from nature, human behaviour, the magic world of children, intuit and instinct of living creatures. She creates her art in various mediums and uses different techniques and materials.



Vlora (Hajdini) Hajrullahu - Lindur me 23.09.1976 në Prishtinë. Diplomoi në Fakultetin e Arteve/ pikturë, Universiteti i Prishtinës. Gjatë karrierës së saj është inkuadruar në shumë projekte artistike si në kostumografi, scenografi, realizim të rekuizitave, kukullave dhe maskotave për teater si dhe krijimtari në fushën e artit vizuel e konceptual. Viteve të fundit është duke punuar shumë në

eksplorimin e dizajnit artizanal dhe vërijen në funksion të artizanateve tradicionale duke e pershtatur me artin bashkëkohor. Është themeluese dhe drejtuese e Art Craft Gallery / studio galeri me punime artizanale e cila vazhdon të jetë e hapur. Së fundmi është inkuadruar në fushën e edukimit në Galerinë Kombëtare të Kosovës. Vlora jeton dhe vepron në Prishtinë.

Vlora Hajrullahu - "Take-Take me" Born on 23.09.1976 in Prishtina. Graduated from the Faculty of Arts / Painting, University of Prishtina. During her career, she has been involved in many artistic projects such as costume design, scenography, realization of puppets and mascots for theater as well as creativity in the field of visual and conceptual art. In recent years she has been working hard on exploring handicraft design and also putting traditional handicrafts to work by adapting them into contemporary art. She is the founder and director of Art Craft Gallery /studio with handicrafts which continues to be open. She recently joined the field of education at the National Gallery of Kosovo. Vlora lives and works in Prishtina.



Zake Prelvukaj ka diplomuar në vitin 1991 në Fakultetin e Arteve për Pikturë, në klasën e profesor Nysret Salihamixhiqit. Në vitin 1993 filloi punën si docente në lëndën Pikturë Monumentale. Në vitin 1997, ajo i përfundoi studimet master për Pikturë në klasën e profesor Musli Mulliqit dhe në vitin 2000 merr

klasën e pikturës me titullin Profesor i asociuar i Pikturës.

Në vitin 2010, ajo kalon si profesor i rregullt për Pikturë. Herë pas here, ajo ligjëron në fakultete dhe institucione të kulturës të vendeve të ndryshme. Vlen të përmendet ligjëratat në Diksmuide, e mbajtur në Muzeun e Paqes, që është muzeu më i madh në Evropë, ligjëratë që ajo e mbajti para deputetëve dhe senatorëve të Parlamentit Evropian, si dhe para shumë mysafirëve të tjerë me temën POLITIKA DHE ARTI. Ajo merret edhe me kritikë arti dhe shkrime, të cilat janë botuar në disa gazeta vendore. Përmes ndërmarrjes artistike NEW BALKAN, ajo ka realizuar projektet në vend dhe jashtë si murale, mozaikë, art publik, ekspozita, debate, etj. Është disa vite ajo është në proces të realizimit të shtëpisë së artistëve.

Shumë prej veprave të saj janë në pronësi të personaliteteve të njohura, si nga Muzeu Kombëtar i Grave në Art (NATIONAL MUSEUM OF WOMEN IN THE ARTS), Uashington, i cili është i vetmi në botë i këtij lloji, si dhe nga Galeria NWG në Kembrixh dhe nga Galeria e Arteve në Kosovë. Jeton dhe vepron në Prishtinë.

Zake Prelvukaj graduated in 1991 from the Faculty of Arts, Painting, in the class of Professor Nysret Salihamixhiqi. In 1993 she started working as an Assistant Professor in the subject Monumental Painting. In 1997 she completed her Master studies in Painting, in the class of Professor Musli Mulliqi, and in 2000 started working as Associated Professor for the subject Painting.

In 2010 she received the title Ordinary Professor for painting. Occasionally she gave lectures at faculties and culture institutions in different countries. The Lecture in Diksmuide is worth mentioning. It was held in Museum of Peace - the biggest museum in Europe, where she gave a lecture in front of members of European parliament and senate and many other guests, on the topic POLITICS AND ART. She was also involved in art critics and some writings, which were published in several local newspapers. She implemented projects in country and abroad, such as: murals, mosaics, public art, exhibitions, debates, etc. through the artistic establishment NEW BALKAN. For several years now, she is in the process of establishing the house of artists.

Many of her works are owned by different well known personalities, by the foundation NACIONAL MUSEUM OF WOMEN IN THE ARTS in Washington, the only one of this kind in the world, as well as by Gallery NWG in Cambridge and NGK. She lives and works in Prishtina.





KONCERT – ANSAMBLI “ZANAT”

📅 15.10.2020 - DITA E PARË (E ENJTE)

🕒 21:30 – 22:30

📍 TEATRI ODA

Soliste: ADELINA THAQI-META, ELIDA KRYEZIU-HOTI, DIELLZA SYLEJMANI, ARSTINA KELEMENDI DHE ALBANA PIPERKU.
Pianist: EDON RAMADANI

Ansambli “Zanat”, është formuar në fund të vitit 2017-të, nga pesë profesoresha të muzikës dhe të solo këndimit, njëkohësisht, janë anëtare të Korit të “Filarmonisë së Kosovës”.

Emri që përzgjedhën artistet Prishtinase për ansamblin e tyre, “Zanat”, që në anglisht i bie «the voices», por që në shqip ngërthen e përmban edhe disa kuptime krejtësisht tjera që vijnë nga mitologjia - shpalon pa mëdyshje, shumësinë e misioneve dhe caqeve që kanë shënjuar si ansambël, por gjithsesi, edhe si personalitete. Themelueset e Ansambllit “Zanat”, zonjat: Adelina Thaqi-Meta, Diellza Sylejmani, Albana Piperku Sheapi, Arstina Kadiu-Kelmendi dhe Elida Kryeziu-Hoti

“Zanat” duan të shpalojnë gjithandej, këngët e vjetra dhe autoktone shqipe, ato të gjitha varieteteve dhe trevave - qofshin vepra e këngë të Prishtinës, Prizrenit apo Gjakovës - apo qofshin “Iso-polifonitë” e trevave të Jugut të Shqipërisë - që njihen edhe zyrtarisht nga UNESCO, si “Kryevepra unike, të trashëgimisë gojore të njerëzimit”!

Dhe “Zanat”, po aq sa duan që të ringjallin - shumë pjesë të bukura e të vjetra të muzikës e traditës shqiptare, kryevepra të harruara e përplasma mënjanë, nga dallgët e furishme të këqit e të tallavasë – po aq fuqishëm duan, që të sjellin në jetë - edhe shumë këngë e vepra krejtësisht të reja, që burojnë nga muzat e tyre...!

Adelina Thaqi - Soprano (Prishtinë): Master në “Solo këndim” (Kanto) - në “Akademinë e Arteve në Shkup” (Maqedoni). Znj. Thaqi, është pedagogje dhe Profesoreshë e këndimit, me një përvojë dy dekadësh.

Albana Piperku - Alt (Prishtinë): Ka diplomuar në muzikë, në “Akademinë e Arteve të Prishtinës”, dhe, tash e dy dekada, punon si pedagogje dhe profesoreshë e pianos, gjithashtu është anëtare e korit të “Filarmonisë së Kosovës”

Arstina Kadiu - Mezzo-soprano (Prishtinë): Ka diplomuar në muzikë në “Akademinë e Arteve të Prishtinës”. Është Pedagogje me përvojë të gjatë e muzikës, sikurse edhe anëtare e korit të Filarmonisë së Kosovës.

Diellza Sylejmani - Mezzo-soprano (Prishtinë): Master në solo këndim (Kanto) - e diplomuar në “Akademinë e Arteve në Shkup” (Maqedoni). Znj. Sylejmani është zyrtare e lartë e departamentit të Kulturës, dhe soliste e “Filarmonisë së Kosovës”.

Elida Kryeziu - Soprano (Prishtinë): Master në solo këndim (Kanto), në “Akademinë e Arteve të Tiranës” (Shqipëri). Znj. Kryeziu është anëtare e korit të “Filarmonisë së Kosovës”.

Edon Ramadani - Dirigjent (Mitrovicë): Magjistroi në Dirigjim në Akademinë e Arteve - Shkup (Maqedoni), aktualisht është profesor i dirigjimit në Akademinë e Arteve në Prishtinë.

CONCERT - ENSEMBLE "ZANAT"

📅 15.10.2020 - DAY ONE (THURSDAY)

🕒 21:30 – 22:30

📍 ODA THEATER

Solistes: ADELINA THAQI-META, ELIDA KRYEZIU-HOTI, DIELLZA SYLEJMANI, ARSTINA KELEMENDI DHE ALBANA PIPERKU.

Pianist: EDON RAMADANI

The ensemble *Zánat* (The Voices) was established at the end of 2017 by five soloist singing and music professors, who are simultaneously members of the Philharmonic of Kosovo Choir.

The name these Prishtina artists chose for their ensemble, *Zánat*, could be translated as "The voices", and in Albanian this word could capture several other meanings, including meanings from mythology and this term undoubtedly unveils the multiplicity of missions and goals that they, as an ensemble and as personalities, want to achieve. The founders of *Zánat* are Adelina Thaqi-Meta, Diellza Sylejmani, Albana Piperku Sheapi, Arstina Kadiu-Kelmendi and Elida Kryeziu-Hoti.

Zánat want to unveil all over the country the old and autochthonous Albanian songs; those songs of varieties and regions – whether those come from Prishtina, Prizren or Gjakova – or polyphonic songs of the south of Albania, officially recognised by UNESCO as unique "Masterpieces of the Oral and Intangible Heritage of Humanity."

Zánat – as much as they want to revive many beautiful and old pieces of music of the Albanian tradition, masterpieces that have been forgotten and cast away by the powerful waves of *kitsch* and *talava* music – just that much they want to bring back into life many new songs that stem from their muses.

Adelina Thaqi - Soprano (Prishtina) has a master degree in solo singing (Canto) from the Academy of Arts in Skopje (Macedonia). Mrs. Thaqi is a teacher and solo singing pedagogue with an experience of more than 20 years.

Albana Piperku - Alto (Prishtina) has graduated in music from the Academy of Arts in Prishtina, and for the past two decades works as a piano teacher and pedagogue. She is also member of the Philharmonic of Kosovo Choir.

Arstina Kadiu - Mezzo-soprano (Prishtina) has graduated in music from the Academy of Arts in Prishtina. She has a long experience as a music teacher, and is also member of the Philharmonic of Kosovo Choir.

Diellza Sylejmani - Mezzo-soprano (Prishtina) has a master degree in solo singing (Canto) and graduated from the Academy of Arts in Skopje (Macedonia). Mrs. Sylejmani is a senior official at the Department of Culture and a soloist of the Philharmonic of Kosovo.

Elida Kryeziu - Soprano (Prishtina) has a master degree in solo singing (Canto) and graduated from the Academy of Arts in Tirana (Albania). Mrs. Kryeziu is member of the Philharmonic of Kosovo Choir.

Edon Ramadani - Conductor (Mitrovica) has a master degree in conducting from the Academy of Arts in Skopje (Macedonia) and is currently working as a professor of conducting in the Academy of Arts in Prishtina.



PUBLIKIMI I RAPORTIT & KONFERENCË

"Drejt Solidaritetit dhe Bashkëpunimit" - analizë mbi përfaqësimin e grave në shoqëri civile, media dhe institucione të kulturës në Kosovë.

REPORT PUBLISHING & CONFERENCE

"Towards Solidarity and Cooperatio" - an analysis women's representation in civil society, media and cultural institutions in Kosovo.

📅 **16.10.2020 - DITA E DYTË/DAY TWO (E PREMTE/FRIDAY)**
🕒 **11:00 – 15:00**
📍 **TEATRI ODA / ODA THEATER**

Autore/Author: GRESA RRAHMANI

Publikimi i Raportit & Konferencë

"Drejt Solidaritetit dhe Bashkëpunimit" - analizë mbi përfaqësimin e grave në shoqëri civile, media dhe institucione të kulturës në Kosovë.

Fjalë hyrëse: Nasrin Pourghazian - Zëvendëse e Shefit të Misionit, Shefe e Bashkëpunimit për Zhvillim, Vlora Dumoshi - Ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Republikën e Kosovës.

Prezantimi i Raportit: Gresa Rrahmani – Autore.

Paneli 1: "Përfaqësimi i grave në shoqëri civile, media dhe institucione të kulturës" – Perspektiva ndërkombëtare dhe vendore.

Panelistet: Tenzin Dolke - Aktiviste dhe Feministe, Blerta Basholli, - Drejtoreshë e drejtorisë së kulturës në komunën e Prishtinës, Nermin Mahmuti- Drejtoreshë Ekzekutive, Fondi për zhvillim komunitar, Moderator: Donika Emimi – Drejtoreshë Ekzekutive e Platforms Civikos.

Paneli 2: "Përfaqësimi i grave në shoqëri civile, media dhe institucione të kulturës" në Kosovë.

Panelistet: Tijana Simić LaValley - Drejtore e programit në OJQ "Të drejtat e grave" dhe aktiviste për të drejtat e grave. Saranda Bogujevci - Anëtare e Parlamentit të Republikës së Kosovës, Valdete Idrizi - Anëtare e Parlamentit të Republikës së Kosovës, Ivane Petronic Vanovac - Radio KM, Luljeta Demolli – Drejtoreshë Ekzekutive – Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Moderator: Donika Emimi – Drejtoreshë Ekzekutive e Platforms Civikos.

Hulumtimi fokusohet në tri fusha: shoqërinë civile, media dhe institucionet kulturore, dhe synon të analizojë se çfarë ndikimi ka rritja e numrit të grave në pozita vendimmarrëse. Në rastet kur gratë janë udhëheqëse të institucioneve a ka ndryshime në politikat e këtyre institucioneve? Nëse po, si manifestohen këto ndryshime. A ka përmirësime në jetën dhe përfaqësimin më të lartë të grave tjera si dhe personave të marginalizuar, minoriteteve dhe grave e burrave me aftësi të kufizuara? A ka ndryshime në miratimin e politikave më të barabarta dhe përfitimë të tjera për komunitetin?

Report Publishing & Conference

